

## **Njoftim për mediat**

### **Mbi memorandumimin e mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës (AK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM)**

**Tiranë 23 shkurt 2011** – Autoriteti i Konkurrencës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (në vijim DPPM) nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional për lehtësimin e kryerjes së funksioneve përkatëse të këtyre institucioneve. Ky memorandum u nënshkrua nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës Znj. Lindita Milo (Lati) dhe Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (në vijim DPPM) z. Safet SULA, në mjediset e AK.

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve është e nevojshme pasi si synim final të ushtrimit të aktivitetit të tyre kanë mbrojtjen e bizneseve dhe të konsumatorëve dhe të interesave të tyre. Interesi publik për respektimin e të drejtave të pronësisë mbi markat dhe patentat mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikës dhe rëndësisë që ka ky sektor.

**Autoriteti** dhe **DPPM** kanë përgjegjësinë e sigurimit të mjeteve ligjore të nevojshme për mbrojtjen e bizneseve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive që shkelin parimet e konkurrencës së lirë si dhe të atyre veprimeve që cenojnë të drejtat e pronarëve ose mbajtësve të të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale, kryesisht patentave dhe markave, si dhe dëmtojnë interesat e ligjshme të konsumatorëve.

Më konkretisht, palët angazhohen që të përcaktojnë fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për të mbrojtur konkurrencën në rastet kur evidentohen forma të abuzimit me pozitën dominuese të një ose disa subjekteve në treg.

Në këtë drejtim Autoriteti bashkëpunon për nxitjen e konkurrencës duke dhënë mendimet e tij për aktet ligjore dhe nënligjore që vendosin rregulla sjellje në këtë sektor. Të gjitha projektet e akteve nënligjore të nxjerra prej palëve, që lidhen me operatorët e këtij sektori dhe që referojnë vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për operatorë të caktuar, do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin, me qëllim funksionimin normal të sektorit në përputhje me objektivat e detyrimit ligjore.



Ligji nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) në pjesën e pestë të tij, vendos detyrimin e enteve të ndryshme shtetërore që të kërkojnë vlerësimi e Autoritetit të Konkurrencës për projekt-aktet që mund të sjellin një kufizim apo pengim të konkurrencës. Gjithashtu, ligji përcakton bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës me entet e ndryshme rregullatorë për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorët e rregulluar. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar një sërë memorandumesh bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, AKEP, ERE, ERU etj.

**Autoriteti i Konkurrencës** është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën;

**DPPM** është institucioni përgjegjës për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale në Shqipëri dhe është Institucioni Shtetëror që siguron njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave mbi objektet e Pronësisë Industriale që janë: Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit; Dizenjot Industriale, Markat Tregtare dhe të Shërbimit; Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës, Topografitë e Qarqeve te Integruara etj.